



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: 16.2.2023

Nr: 6

Ora: 17:00

V E N D I M

P Ë R

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 4, DATË 13.11.2020, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, "PËR LLOJIN DHE KARAKTERISTIKAT TEKNIKE QË DUHET TË PLOTËSOJNË SISTEMET DHE PAJSJET E VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK QË PROKUROHEN DHE PËRDOREN NË ZGJEDHJE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja "e" dhe të nenit 22, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 4, datë 13.11.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë:

"1. Procesi i votimit dhe numërimit elektronik të votave ku do të zbatohen projekte pilot do të kryhet me anë të sistemit dhe/ose pajisjeve elektronike, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

b) Shkronja "m", e pikës 10, ndryshohet, si më poshtë:

"m. Pas mbylljes të procesit të votimit, për qëllim të pasqyrit të rezultatit paraprak të çdo qendre votimi, PEVN, pasi printon procesverbalin e rezultatit të votimit, mundëson transmetimin e këtij rezultati me siguri maksimale dhe pa çënuar integritetin e informacionit drejt Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Votave dhe Rezultateve (SEMVR) në KQZ dhe jo anasjelltas. Rregullat mbi llojin e të dhënave që transmetohen, raportet e printuara nga PEVN dhe administrimin e tyre miratohen me akt të Komisionit Rregullator."

Data: 16.2.2023 Nr: 6
Ora: 17:00



Për disa ndryshime në vendimin nr. 4, datë 13.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

- c) Shkronja “n”, e pikës 10, shfuqizohet.
ç) Pika 12, shfuqizohet.
2. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar